

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**40 HADITHE
RRETH EKONOMISË
DHE MENAXHIMIT
TË PASURISË**

Tiranë, 2026

Titulli: 40 Hadithe rreth ekonomisë dhe menaxhimit të pasurisë

Autori: Qendra “Nun”- Qendra për Autorësi dhe Përkthim

I përktheu nga arabishtja: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

I redaktoi: Jerida KULLA

I korrektoi: Ma. Isra MERJA

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie FEZA

Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: Fondacioni i Kur'anit - Tiranë, 2026

DY FJALË¹

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

*Falënderimet i takojnë Allahut të
Madhëruar! Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi
Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër
dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!*

1 Marrë nga libri: “Kutaf Shehr Ramazan”, f. 102-104, i Shejkh Hysen Abdul Ridha El Esedij; dhe nga libri: “En Nidhamul iktisadij fil Islam”, i Shehijd Murteda El Mutaharit.

I Dërguari i Allahut, vula e profetëve, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Ehli Bejti i tij i pastër (Paqja qoftë mbi ta!), na kanë lënë një trashëgimi madhështore, thëniet e tyre të bekuara, të cilat përfshijnë gjithë jetën e njeriut. Nëse njeriu interesohet për ato thënie, i lexon, i kupton dhe i zbaton në jetën e tij të përditshme, do të arrijë në përfundimin bindës se ato i sigurojnë atij lumturinë në të dyja jetët.

Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti i tij na nxisin që t'i mësojmë përmendësh hadithet e tyre, me qëllim që të bëhen pjesë e kulturës dhe e edukatës sonë dhe, kështu, të afrohem tek Allahu i Madhëruar. Kjo gjë

ka shumë dobi për besimtarin në Jetën Tjetër.

Në një hadith të ardhur nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), thuhet: *“Ai që mëson përmendsh dyzet hadithe, Allahu do ta ringjallë në Ditën e Ringjalljes të ditur dhe jurist (fakih)”*.

Duke e çmuar fort këtë pasuri të trashëguar nga Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti, Fondacioni i Kur'anit ka përzgjedhur, ka mbledhur dhe ka përkthyer në gjuhën shqipe “40 hadithe rreth ekonomisë dhe menaxhimit të pasurisë”.

Allahu na mbarësoftë të gjithëve në ruajtjen dhe përhapjen e kësaj trashëgimie të vyer e të begatë të Profetit Muhamed

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të familjes së tij të pastër!

Ekonomia në Kur'anin e shenjtë

Kuptimi i ekonomisë

Ekonomia është një shkencë që merret me gjithçka që ka të bëjë me pasurinë, paranë, fitimin, pronësinë dhe shpenzimet. Ajo trajton, gjithashtu, çështje që lidhen me prodhimin dhe investimin, përfitimin dhe shërbimet, kursimin dhe ruajtjen, si dhe pasurinë dhe varfërinë.

Fjala “ekonomi” nuk përmendet drejtpërdrejt në Kur'anin e shenjtë, edhe pse Kur'ani flet për çështje që lidhen me të.

Për këtë, armiqtë e Islamit përhapin një ide të rreme ndaj Kur'anit dhe Islamit, sipas së cilës thuhet: "Islami nuk ka ekonomi dhe Kur'ani nuk ka trajtuar çështje ekonomike, prandaj kjo është një mangësi në Kur'an".

Kjo është një thënie që nuk ka aspak lidhje me realitetin dhe tregon padijen e atij që e thotë këtë për Kur'anin e shenjtë, sepse përsiatja në ajetet e Kur'anit dhe në ligjet islame na zbulojnë një sistem të plotë ekonomik, që zgjidh problemet ekonomike të njerëzimit që nga rrënjët.

Për sa i përket themelit të problemit ekonomik, Islami nuk e konsideron që burimi i problemit qëndron në konfliktin e vazhdueshëm mes rritjes së popullsisë dhe

mungesës së burimeve natyrore, siç thotë kapitalizmi. Po ashtu, nuk e konsideron që problemi qëndron në kontrastin mes sektorit të prodhimit dhe atij të shpërndarjes, siç pretendon socializmi marksist. Përkundrazi, Islami e sheh që njeriu është baza e problemit dhe çelësi i zgjidhjes së tij.

Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an:
“Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën. Ai lëshon ujë nga qielli e nëpërmjet tij nxjerr fruta si ushqim për ju. Ai i ka vënë në shërbimin tuaj anijet, që me lejen e Tij, ju të lundroni me ato nëpër dete. Ai i ka krijuar lumenjtë për dobinë tuaj e po ashtu edhe Diellin dhe Hënën, që lëvizin vazhdimisht. Ai ka

vënë në shërbimin tuaj natën dhe ditën. Ai ju jep gjithçka që i kërkon. Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës”.²

Islami përcakton tri lloje të pronësisë: pronësi publike, pronësi private dhe pronësi shtetërore. Të gjitha këto forma përfaqësojnë një realitet natyror në sistemin ekonomik islam. Ndryshe nga kapitalizmi, që e konsideron pronën publike si diçka të jashtëzakonshme apo marksizmi, që e sheh pronën private si një

2 Sure “Ibrahim”, ajetet 32-34.

devijim, Islami i pranon të tria si pjesë të ekuilibruara të ekonomisë së tij.

Megjithatë, Kur'ani i shenjtë pronën e njeriut, në çfarëdo forme qoftë ajo, e quan si një pronë të përkohshme. Pronësia e vërtetë i takon Allahut të Madhëruar. Allahu thotë: **“Të Allahut është mbretëria e qiejve dhe e tokës dhe te Allahu është përfundimi (kthimi i fundit)”**.³ Ky është një kuptim që përsëritet në shumë ajete të tjera.

Duke qenë se pasuria i përket Allahut, Ai na ka ngarkuar me disa detyrime të përcaktuara në sheriatin islam, ndër to është edhe shpenzimi në rrugë të

3 Sure “En Nur”, ajeti 42.

Allahut. Allahu thotë: “O ju që keni besuar! Shpenzoni nga ajo që ju kemi dhënë, para se të vijë një ditë kur nuk do të ketë as tregti, as miqësi dhe as ndërmjetësim. Mohuesit janë ata që bëjnë padrejtësi”.⁴

Gjithashtu, thotë: “Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe shpenzoni nga ajo që Ai ju ka bërë përgjegjës për të. Ata që besojnë nga ju dhe shpenzojnë, do të kenë shpërblim të madh”.⁵

4 Sure “El Bekare”, ajeti 254.

5 Sure “El Hadid”, ajeti 7.

Po ashtu, Allahu thotë: **“Dhe jepuni atyre nga pasuria e Allahut që Ai jua ka dhënë...”**⁶

Është transmetuar se Imam Xhaferr Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha Isait, birit të Musait: “O Isa! Pasuria është pasuri e Allahut. Ai e ka vendosur atë te krijesat e Tij dhe i ka urdhëruar ata që të hanë prej saj me masë, të pinë prej saj me masë, të vishen prej saj me masë, të martohen prej saj me masë, të hipin (udhëtojnë) prej saj me masë dhe atë që mbetet përtej kësaj, ta kthejnë te të varfrit besimtarë...”⁷

6 Sure “En Nur”, ajeti 33.

7 “A’lamu Ed Dijn i El Dejlemi”, f. 269.

Islami i jep ekonomisë një ngjyrim real, që është në përputhje me natyrën e njeriut. Ai nuk e urdhëron njeriun të braktisë plotësisht çështjet materiale e as të injorojë krejtësisht shpirtëroren. Përkundrazi, Allahu thotë: **“Por përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët”**.⁸

Po ashtu, Islami e rrethon ekonominë me etikë dhe i jep përparësi interesit të përgjithshëm mbi atë personal,

⁸ Sure “El Kasas”, ajeti 77.

kur të dy përplasen, duke u mbështetur në parimin: *“Nuk ka dëm dhe nuk lejohet të shkaktohet dëm në Islam”*.⁹

Islami ka burime të caktuara për të mbushur thesarin e shtetit islam, të cilat përmbledhtas përfshijnë: burimet natyrore (toka, lumenj, burime uji, puse, minerale etj.), khumsi (një e pesta), zekati, haraxhi (taksat mbi tokën), xhizjeja (taksa që paguanin jobesimtarët në shtetin islam).

Islami solli ligje ekonomike që organizojnë jetën shoqërore, nxisin lëvizjen ekonomike dhe zgjidhin problemin

⁹ Shiko: “El Kafi” i El Kulejnit, vëll. 5, K. “Dëmi” (ed darar), Hadithi 8, f. 294.

njerëzor. Allahu thotë: **“Allahu e lejoi tregtinë dhe e ndaloi kamatën...”**¹⁰

Dhe: **“Mjerë ata që hanë në peshë (dhe matje)”**.¹¹

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) ka thënë: *“Ai që bën monopol, është i mallkuar”*.¹²

Dhe: *“Kush grumbullon ushqim për të pritur ngritjen e çmimeve për dyzet ditë, është*

10 Sure “El Bekare”, ajeti 275.

11 Sure “El Mutaffifijn”, ajeti 1.

12 “Aualu El Li’alij i El Ahsai, vëll. 2, K. “Tregtia”, Hadithi 3, f. 242; “Mustedrek El Hakim”, vëll. 2, f. 11.

i larguar nga mëshira e Allahut dhe Allahu është larguar prej tij”.¹³

Allahu i Madhëruar thotë: **“O besimtarë, mos e përvetësoni pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejueshme, përveç rastit kur ajo është tregti me pëlqim të dyanshëm dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju”.**¹⁴

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Merruni me tregti, sepse ajo ju pasuron dhe ju çliron nga ajo që është në duart e njerëzve. Me të

13 “Biharul Enuar”, El Mexhlisi, vëll. 59, f. 292.

14 Sure “En Nisa”, ajeti 29.

vërtetë, Allahu e do robin e zellshëm dhe të besueshëm”.¹⁵

Pasuria nuk është e refuzuar në Islam. Ajo që është e refuzuar dhe e ndaluar, është shpërdorimi, shpenzimi i tepruar dhe shkatërrimi i pasurisë.

Islami nuk e pranon fitimin e pasurisë, nëse pasuria do ta bëjë njeriun viktimë të saj. Prandaj Islami e ka kundërshtuar fuqimisht një gjë të tillë dhe e ka dënuar ashpër skllavërinë e njeriut ndaj pasurisë, ndjekjen e saj vetëm për ta mbledhur, ruajtur dhe grumbulluar. Në Librin e shenjtë thuhet: **“... Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e**

15 “El Khisal” i Es Sadukut, f. 621, Hadithi 400.

shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm".¹⁶ Kjo quhet lakmi, koprraci dhe pangopësi.

Po ashtu, Islami e dënon mbledhjen e pasurisë vetëm për të kënaqur barkun, për të mbijetuar fizikisht, për të jetuar në përtaci dhe dembelizëm. Kjo mënyrë e të jetuarit është quajtur kënaqje e epsheve, ku grumbullimi i pasurisë bëhet sinonim i poshtërimit dhe shndërrohet në një faktor që shkrin personalitetin e njeriut dhe zhduk çdo aspekt të njerëzores dhe virtytit të lartë shpirtëror.

16 Sure "Et Teube", ajeti 34.

Njeriu duhet ta konsiderojë pasurinë si mjet për punë, ndikim dhe prodhimtari. Në këtë rast, pasuria bëhet një element në shërbim të një qëllimi më të lartë për të cilin njeriu e dëshiron atë. Në një hadith të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), thuhet: “Sa e mirë është pasuria për një njeri të mirë!”

Islami nuk e ka dënuar pasurinë, por ka dënuar robërinë ndaj saj. Kjo del në pah nëpërmjet disa parimeve:

a) Islami ka rekomanduar prodhimin e pasurisë në fusha, si: bujqësia, blegtoria dhe industria.

b) Ka rekomanduar shkëmbimin e pasurisë, tregtinë dhe ekonominë.

c) Ka këshilluar shpenzimin e pasurisë në kufijtë e nevojave personale, duke shmangur çdo lloj shpërdorimi dhe ekstravagance që e dëmton njeriun.

d) Islami ka ndaluar shpërdorimin, teprimin dhe shkatërrimin e pasurisë.

e) Ka vendosur ligje të ashpra juridike dhe penale në rastet e padrejtësisë, devijimit, vjedhjes dhe tradhtisë.

f) Islami e ka barazuar mbrojtjen e pasurisë me xhihad dhe e ka shpallur dëshmor atë që vritet duke mbrojtur pasurinë apo familjen.

g) Islami i ka dhënë të drejta dhe detyrime pasurisë ndaj njeriut.

h) Dhe, në fund, Kur'ani e ka quajtur vetë pasurinë “mirësi” (khajr), siç thotë: **“Kur ndokujt prej jush i afrohet vdekja dhe ai lë pas pasuri (mirësi), i është bërë detyrim të lërë testament për prindërit dhe të afërmit...”**¹⁷

17 Sure “El Bekare”, ajeti 180.

**40 HADITHE
RRETH EKONOMISË
DHE MENAXHIMIT
TË PASURISË**

Hadithi 1

Çfarë është ekonomia?

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Kush shpenzon në atë që nuk është e drejtë, ka bërë shpërdorim; dhe kush nuk shpenzon aty ku është e drejtë, ka treguar koprraci”*.¹⁸

عن رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم: "من أعطى في غير حق فقد أسرف، ومن منع من حق فقد قتر" (بحار الأنوار - العلامة المجلسي - ج 66 ص 261).

¹⁸ “Biharul Enuar”, i eruditit El Mexhlisi, vëll. 66, f. 261.

Hadithi 2

Ebu Abdullahu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), recitoi ajetin: **“Dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk shpërdorojnë dhe as nuk bëhen koprracë, por qëndrojnë në mes të kësaj”**.¹⁹

Pastaj mori një grusht gurësh dhe e shtrëngoi fort dorën, duke thënë: *“Kjo është koprracia që Allahu e ka përmendur në Librin e Tij”*.

Më pas mori një grusht tjetër dhe e hapi dorën krejtësisht, duke thënë: *“Ky është shpërdorimi.”*

Pastaj mori një grusht të tretë, e hapi dorën në mënyrë të moderuar, duke

19 Sure “Furkan”, ajeti 67.

mbajtur një pjesë dhe duke lënë pjesën tjetër, dhe tha: “Ky është ekuilibri”.²⁰

تلا أبو عبد الله عليه السلام هذه الآية: "وَالَّذِينَ إِذَا أَنْفَقُوا لَمْ يُسْرِفُوا وَلَمْ يَقْتُرُوا وَكَانَ بَيْنَ ذَلِكَ قَوَامًا" فأخذ قبضة من حصى وقبضها بيده، فقال: هذا الإقتار الذي ذكره الله عز وجل في كتابه، ثم قبض قبضة أخرى فأرخى كفّه كلّها، ثم قال: هذا الإسراف، ثم أخذ قبضة أخرى فأرخى بعضها وأمسك بعضها وقال: هذا القوام².
(الكافي - الشيخ الكليني - ج 4 ص 55).

²⁰ “El Kafi”, Shejkh Kulejni, vëll. 4, f. 55.

Hadithi 3

Ebu Hasani (Paqja qoftë mbi të!), në lidhje me fjalën e Allahut: **“Dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk bëjnë as shpërdorim e as nuk janë koprracë, por mbajnë një qëndrim të mesëm ndërmjet tyre”,** ka thënë: *“Maturia qëndron në mënyrën e shpenzimit. Ai që ka pasuri, le të shpenzojë sipas mundësive të tij, ndërsa ai që ka më pak mundësi, le të shpenzojë aq sa i nevojitet atij dhe familjes së tij për mirëqenien e tyre. Allahu*

nuk e ngarkon askënd përtej mundësive të veta".²¹

عن أبي الحسن عليه السلام: "في قول الله عز وجل: "وَالَّذِينَ إِذَا أَنفَقُوا لَمْ يُسْرِفُوا وَلَمْ يَقْتُرُوا وَكَانَ بَيْنَ ذَلِكَ قَوَامًا" قال: القوام هو المعروف، على الموسع قدره، وعلى المقتر قدره على قدر عياله ومؤنته التي هي صلاح له ولهم، "لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا مَا آتَاهَا" (وسائل الشيعة (آل البيت) - الحر العاملي - ج 21 - ص 555 - 557).

21 "Uesailu Esh Shiah", El Hurr Amili, vëll. 21, f. 555-557.

Hadithi 4

Imam Musa El Kadhimi (Paqja qoftë mbi të!), kur u pyet për shpenzimet për familjen, ka thënë: *"Shpenzimi duhet të jetë ndërmjet dy gjërave të papëlqyera: shpërdorimit dhe koprracisë"*.²²

عن الإمام الكاظم عليه السلام - لما سئل عن النفقة على العيال - : "ما بين المكروهين: الإسراف والإقتار" (م.ن.-
ج21 ص556).

²² Po aty: vëll. 21, f. 556

Hadithi 5

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Dhurimi i pasurisë në atë që nuk është e drejtë,
është shpërdorim dhe ekstravagancë”.²³

عن الإمام علي عليه السلام: "إعطاء المال في غير حقّه تبذير
وإسراف". (بحار الأنوار - العلامة المجلسي - ج 32 ص 48).

²³ “Biharul Enuar” i eruditit El Mexhlisi, vëll. 32, f. 48.

Hadithi 6

Imami Askeriu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Ekonomia ka një masë të caktuar; nëse e tejkalon atë, atëherë bëhet koprraci”*.²⁴

عن الإمام العسكري عليه السلام: "إنَّ للاقتصاد مقداراً، فإن زاد عليه فهو بخل". (ميزان الحكمة - محمد الريشهري - ج 3 - ص 2556 - 2557).

²⁴ “Mizanul Hikme”, Muhamed Reishehri, vëll. 3, f. 2556-2557.

Hadithi 7

Shenjat e atij që shpenzon pa masë

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Shenjat e njeriut shpërdorues janë katër: Mburrja me të kotën, ha atë që nuk e ka, bëhet asket në bërjen mirë, mohon atë nga i cili nuk përfiton asgjë”*.²⁵

25 “Biharul Enuar” i eruditit El Mexhlisi, vëll. 1, f. 122.

عن رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم: "أَمَّا علامة المسرف
فأربعة: الفخر بالباطل، ويأكل ما ليس عنده، ويزهد في اصطناع
المعروف، وينكر من لا ينتفع بشيء منه". (بحار الأنوار - العلامة
المجلسي - ج 1 ص 122).

Hadithi 8

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*“Shpërdoruesi ka tri shenja: ha atë që nuk i përket, blen atë që nuk i takon dhe vishet me atë që nuk është e tij”.*²⁶

عن أمير المؤمنين عليه السلام أنه قال: "للمسرف ثلاث علامات:
يأكل ما ليس له، ويشترى بما ليس له، ويلبس ما ليس له".
(وسائل الشيعة (آل البيت) - الحر العاملي - ج 17 ص 65).

26 “Uesa’ilu Esh Shi’a”, Hurrul Amili, vëll. 17, f. 65.

Hadithi 9

Ebu Abdullahu, Imam Xhaferr Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: *“Ekuilibri në shpenzim është një çështje që Allahu i Lartësuar e do, kurse shpërdorimi është diçka që Allahu e urren, madje edhe hedhjen e një bërthame që mund të jetë e dobishme për diçka, apo derdhjen e mbetjes së pijes tënde”*.²⁷

عن أبي عبد الله عليه السلام قال: "إِنَّ الْقَصْدَ أَمْرٌ يُحِبُّهُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ، وَإِنَّ السَّرْفَ أَمْرٌ يَبْغِضُهُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ حَتَّى طَرَحَكَ النَّوَاءُ، فَإِنَّهَا تَصْلَحُ لَشَيْءٍ وَحَتَّى صَبَّكَ فَضَلَ شَرَابُكَ". (الكافي - الشيخ الكليني - ج 4 ص 52)

27 “El Kafi” i Shejkh Kulejnit, vëll. 4, f. 52.

Hadithi 10

Nxitja për ekonomi dhe maturi në shpenzime

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Besimtari e ka marrë edukatën nga Allahu. Kur Allahu ia zgjeron (mirësinë), ai shpenzon me masë dhe, kur ia ngushton, ai mjaftohet me pak”*.²⁸

²⁸ “Mustedrekul Uesail”, Mirza en Nuri, vëll. 13, f. 52.

عن رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم، أنّه قال: "إنّ المؤمن أخذ
من الله أدباً، إذا وسّع عليه اقتصد، وإذا أقر عليه اقتصر". (مستدرک
الوسائل - الميرزا النوري - ج 13 - ص 52).

Hadithi 11

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), në një letër drejtuar Zijadit, ndër të tjera ka thënë: *“Lëre shpërdorimin dhe ndiq rrugën e maturisë. Kujto të ardhmen, ndërsa je në të tashmen. Ruaj nga pasuria aq sa të nevojitet, ndërsa tepricën dërgoje për ditën kur do të jesh në nevojë”*.²⁹

عن أمير المؤمنين عليه السلام من كتاب له إلى زياد: "دع الإسراف مقتصدًا، واذكر في اليوم غداً، وأمسك من المال بقدر ضرورتك، وقدم الفضل ليوم حاجتك". (بحار الأنوار - العلامة المجلسي - ج 33 ص 490).

29 “Biharul Enuar” i eruditit El Mexhlisi, vëll. 33, f. 490.

Hadithi 12

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Përmbajtja e atij që është i matur (në shpenzim) është më e mirë se dhurimi i shpërdoruesit; mosdhënia e atij që di të ruajë, është më e bukur se dhënia e atij që e humb (e shpërdoron)”.³⁰

وعن الإمام عليّ عليه السلام: "إنّ منع المقتصد أحسن من عطاء المبدّر، إنّ إمساك الحافظ أجمل من بذل المضيّع". (ميزان الحكمة - محمد الرিশهري - ج 2 - ص 1295).

30 “Mizanul Hikme”, Muhamed Rijshehri, vëll. 2, f. 1295.

Hadithi 13

Në një lutje të Imam Zejnul Abidinit (Paqja qoftë mbi të) thuhet: *“O Allah! Dërgo bekimet e Tua mbi Muhamedin dhe familjen e tij, dhe më ruaj nga shpërdorimi dhe lakmia. Më udhëzo drejt bujarisë dhe maturisë, më mëso të planifikoj me mençuri dhe, me butësinë Tënde, më largo nga shpërdorimi”*.³¹

وفي دعاء الإمام زين العابدين عليه السلام: "اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِهِ، وَاحْبِبْنِي عَنِ السَّرَفِ وَالْإِزْدِيَادِ، وَقَوِّمْنِي بِالْبَذْلِ وَالِاِقْتِصَادِ، وَعَلِّمْنِي حَسْنَ التَّقْدِيرِ، وَاقْبِضْنِي بِلُطْفِكَ عَنِ التَّبَذِيرِ". (الصحيفة السجادية، دعاؤه في المعونة على قضاء الدين، الدعاء الثلاثون).

31 "Sahifetu Es Sexhadijeh", Lutja për ndihmë në shlyerjen e borxhit, lutja e tridhjetë.

Hadithi 14

Imam Muhamed El Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Shenjat e besimtarit janë tri: planifikimi i mirë i jetesës, durimi në prova dhe kuptimi i thellë i fesë. Nuk ka të mirë tek ai që nuk tregohet i matur në jetesën e tij; një i tillë nuk është i dobishëm as për dynjanë dhe as për ahiretin e vet”*.³²

عن أبي جعفر الباقر عليه السلام قال: "من علامات المؤمن ثلاث، حسن التقدير في المعيشة، والصبر على النائية، والتفقه في الدين. وقال: ما خير في رجل لا يقتصد في معيشته، ما يصلح لا لدينه ولا لآخرته". (تهذيب الأحكام - الشيخ الطوسي - ج 7 - ص 236).

32 “Tehdhijbul Ahkam”, Shejkh Tusi, vëll. 7, f. 236.

Hadithi 15

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Ekonomia, sjellja e mirë dhe udhëzimi i drejtë janë pjesë nga më shumë se njëzet pjesë të profetësisë”*.³³

عن رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم: "الاقتصاد وحسن السمات والهدى الصالح جزء من بضع وعشرين جزء من النبوة". (ميزان الحكمة - محمد الريشهري - ج 3 - ص 2556 - 2557).

³³ “Mizanul Hikme”, Muhamed Rijshehri, vëll. 3, f. 2556-2557.

Hadithi 16

Shpërdorimi i lavdëruar

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Nuk ka mirësi në shpërdorim dhe nuk ka shpërdorim në mirësi”*.³⁴

عن رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم: "لا خير في السرف، ولا سرف في الخير" (بحار الأنوار - العلامة المجلسي - ج 74 ص 165).

³⁴ “Biharul Enuar” i eruditit El Mexhlisi, vëll. 74, f. 165.

Hadithi 17

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Shpërdorimi është i dënuar në çdo gjë, përveç
veprave të mirë”.³⁵

عن الإمام علي عليه السلام: "الإسراف مذموم في كل شيء إلا
في أفعال البر". (میزان الحکمة - محمد الرشدي - ج 2 - ص 1295 -
(.1296)

35 “Mizanul Hikme” i Muhamed Rijshehri, vëll. 2,
f. 1295-1296.

Hadithi 18

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*“Qëndrueshmëria e jetës është në planifikimin
e mirë dhe themeli i saj është në menaxhimin e
mirë”*.³⁶

عن الإمام علي عليه السلام: "قوام العيش حسن التقدير، وملاكه
حسن التدبير". (عيون الحكم والمواعظ - علي بن محمد الليثي الواسطي -
ص 370).

³⁶ “Ujunul Hikami uel Meuaidh”, Ali ibn Muhamed el Lejthij El Uasiti, f. 370.

Hadithi 19

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*"Jini të matur në ushqim, sepse kjo ju largon nga shpërdorimi, e mban trupin më të shëndetshëm dhe ju ndihmon më shumë në adhurim".*³⁷

عن الإمام علي عليه السلام: "عليكم بالقصد في المطاعم فإنه أبعد من السرف، وأصح للبدن، وأعون على العبادة". (م.ن، - ص 341).

³⁷ Po aty, f. 341.

Hadithi 20

Në një lutje të Imam Zejnul Abidinit (Paqja qoftë mbi të) thuhet: *“Më ndalo nga shpërdorimi, ruaje furnizimin tim nga shkatërrimi, bekoje pasurinë time duke e shtuar atë dhe më udhëzo ta shpenzoj në rrugët e mirësisë”*.³⁸

من دعاء الإمام زين العابدين عليه السلام: "وامنعني من السرف،
وحصّن رزقي من التلف، ووفّر ملكتي بالبركة فيه، وأصّب بي
سبيل الهداية للبرّ فيما انفق منه". (الصحيفة السجادية، دعاء مكارم
الأخلاق، الدعاء العشرون.)

38 “Sahife Es Sexhadijeh”, Lutja për moralet e larta, lutja e njëzetë.

Hadithi 21

Është transmetuar nga Ebu Abdullahu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), i cili i ka thënë Ubejdit: “O Ubejd... Me të vërtetë, matura në shpenzim sjell pasuri”.³⁹

عن أبي عبد الله عليه السلام أنه قال له: "يا عبيد... وإنَّ القصد يورث الغنى"². (الكافي - الشيخ الكليني - ج 4 ص 53).

39 “El Kafi” i Shejkh Kulejnit, vëll. 4, f. 53.

Hadithi 22

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*“Shpërdorimi çon në humbje (të pasurisë),
ndërsa maturia çon në shtim (të pasurisë)”*.⁴⁰

عن الإمام عليّ عليه السلام: "السرف مثواة، والقصد مثناة". (بحار
الأنوار - العلامة المجلسي - ج 66 ص 379. المثواة: ما يسبب الخسارة والضياع
. والمثناة: ما يسبب مزيد الثروة.)

40 “Biharul Enuar” i eruditit El Mexlisi, vëll. 66, f. 379.

Hadithi 23

Amr ibn Ibrahim ka thënë: “E kam dëgjuar Ebu Hasanin, Imam Kadhimin (Paqja qoftë mbi të!), duke thënë: ‘Sikur njerëzit të ishin të matur në ushqim, trupat e tyre do të ishin të shëndoshë’”.⁴¹

عن عمرو بن إبراهيم، قال: "سمعت أبا الحسن عليه السلام يقول: لو أنَّ الناس قصدوا في الطعام لاستقامت أبدانهم". (المحاسن - أحمد بن محمد بن خالد البرقي - ج 2 - ص 439).

41 “El Mehasin” i Ahmed ibn Muhamed ibn Khalid El Berki, vëll. 2, f. 439.

Hadithi 24

Ali ibn Hyseni, Zejnul Abidini (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: *“Le të shpenzojë njeriu me maturi dhe aq sa mjafton për jetesë, kurse tepërcën le ta dërgojë për Botën Tjetër, sepse kjo është më mbrojtëse për begatinë, më afër shtimit nga Allahu dhe më e dobishme për fundin”*.⁴²

عن علي بن الحسين زين العابدين عليه السلام: "لينفق الرجل بالقسط وبلغه الكفاف، ويقدم منه الفضل لآخرته، فإنّ ذلك أبقى للنعمة، وأقرب إلى المزيد من الله وأنفع في العاقبة". (وسائل الشيعة (آل البيت) - الحر العاملي - ج 21 ص 551 .)

42 “Uesailu Esh Shiah”, Hurrul Amili, vëll. 21, f. 551.

Hadithi 25

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) ka thënë: *“Kush bën ekonomi në jetesën e tij, Allahu do ta furnizojë”*.⁴³

قال رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم: "من اقتصد في معيشته
رزقه الله". (الكافي - الشيخ الكليني - ج 2 ص 122).

43 “El Kafi” i Shejkh Kulejnit, vëll. 2, f. 122.

Hadithi 26

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*“Unë i garantoj atij që është i matur
(ekonomik), se nuk do të varfërohet”.*⁴⁴

قال لإمام الصادق (عليه السلام) :- عليه السلام: "ضمنت لمن
اقتصد أن لا يفتقر"³. (وسائل الشيعة - الحر العاملي - ج 17 - ص
64 - 66).

44 “Uesailu Esh Shiah”, Hurrul Amili, vëll. 17, f. 64-66.

Hadithi 27

Amir ibn Xhedhatu ka thënë: “Një burrë hyri te Ebu Abdullahu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) dhe i tha:

- O Ebu Abdullah, a mund të më japësh një borxh, deri sa të përmirësohet gjendja ime?
- A ke ndonjë të ardhur që pritet të mbërrijë?
- Jo, për Allahun!

- A ke ndonjë tregti që mund të të sjellë fitim?
- Jo, për Allahun.
- A ke diçka që mund ta shesësh?
- Jo, për Allahun.
- Ti je prej atyre që Allahu ka caktuar një pjesë nga pasuria jonë.

Pastaj Ebu Abdullahu mori një qese me para, futi dorën brenda dhe i dha një grusht dërhëmë.

- Ki frikë Allahun, mos shpenzo me teprim dhe mos ji dorështrenguar, por qëndro në mes të të dyjave, sepse shkapërderdhja është pjesë e shpërdorimit. Allahu ka thënë:

“Dhe mos shpërdoroni në shpenzim”. Me të vërtetë, Allahu nuk e dënon atë që është i matur”.⁴⁵

وعن عامر بن جذاعة قال: دخل على أبي عبد الله عليه السلام رجل فقال: يا أبا عبد الله، قرضاً إلى ميسرة، فقال أبو عبد الله عليه السلام: "إلى غلة تدرك" فقال: لا والله، فقال: "إلى تجارة تؤدّي"، فقال: لا والله، قال: "فإلى عقدة تباع" فقال: لا والله، فقال: "فأنت إذاً ممن جعل الله له في أموالنا حقاً" فدعا أبو عبد الله عليه السلام بكيس فيه دراهم، فأدخل يده فناوله قبضة ثم قال: "اتَّقِ الله، ولا تسرف ولا تقتر، وكن بين ذلك قواماً، إن التبذير من الإسراف، قال الله تعالى: "وَلَا تُبَذِّرْ تَبْذِيرًا" إِنَّ اللَّهَ تَعَالَى لَا يَعْذِّبُ عَلَى الْقَصْدِ"¹. (مستدرک الوسائل - المیزان النوری - ج 13 - ص 51 - 52).

⁴⁵ “Mustedrekul Uesail”, Mirza en Nuri, vëll. 13, f. 51-52.

Hadithi 28

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Kush është i matur në pasuri dhe në
varfëri, ai është përgatitur për sprovat e
kohës".⁴⁶

قال علي عليه السلام: "من اقتصد في الغنى والفقر، فقد استعدّ
لنوائب الدهر"². (م.ن، ج 13 - ص 53 - 54).

46 Po aty, vëll. 13, f. 53-54.

Hadithi 29

Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të) ka thënë:
“Dëgjova një burrë t’i thoshte Ebu
Abdullahut, Imam Sadikut (Paqja qoftë
mbi të!): ‘Kam dëgjuar se ekonomia dhe
planifikimi në jetesë përbëjnë gjysmën e fitimit’.
Ebu Abdullahu (Paqja qoftë mbi të!) iu
përgjigj: ‘Jo gjysmën, por të gjithë fitimin!
Madje, planifikimi në jetesë është pjesë e fesë’”.

عن الحسين، قال: سمعت رجلاً يقول لأبي عبد الله عليه
السلام: "بلغني أنّ الاقتصاد والتدبير في المعيشة نصف الكسب.
فقال أبو عبد الله عليه السلام: لا، بل هو الكسب كله، ومن
الدين التدبير في المعيشة"¹ الأماي - الشيخ الطوسي - ص 670).

Hadithi 30

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“*Ekonomia e shton edhe atë që është e paktë*”.⁴⁷

عن أمير المؤمنين عليه السلام، أنه قال: "الاقتصاد ينمي القليل".
(مستدرک الوسائل - الميرزا النوري - ج 13 - ص 53 - 54).

⁴⁷ “Mustedrekul Uesail”, Mirza en Nuri, vëll. 13, f. 53-54.

Hadithi 31

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kush e ndjek ekonominë në jetesë, pasuria do t’i qëndrojë si shok i përhershëm; ajo ia përmirëson varfërinë dhe ia mbulon mangësitë”*.⁴⁸

قال علي عليه السلام: "من صحب الاقتصاد، دامت صحبة الغنى له، وجبر الاقتصاد فقره وخلله" (م. ن. ج 13 - ص 53 - 54).

48 Po aty, vëll. 13, f. 53-54.

Hadithi 32

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Ai që kufizohet në të ngrënë (ha me masë), i
shtohet shëndeti dhe i përmirësohet
mendimi".⁴⁹

عن علي عليه السلام: "من اقتصر في أكله كثرت صحته
وصلحت فكرته". (ميزان الحكمة - محمد الريشهري - ج 1 - ص 89).

⁴⁹ "Mizanul Hikmeh", Muhamed Rijshehri, vëll. 1,
f. 89.

Hadithi 33

Dëmet e shpërdorimit

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) ka thënë: “... *kush shpërdoron, Allahu do ta privojë atë*”.⁵⁰

قال رسول الله صلى الله عليه وآله وسلم: "... ومن بذر حرمه
الله". وسائل الشيعة - الحر العاملي - ج 15 ص 277.

50 “Uesailu Esh Shi’ah”, Hurrul Amili, vëll. 15, f. 277.

Hadithi 34

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*“Shpërdorimi e shkatërron pasurinë e
madhe”*.⁵¹

عن الإمام عليّ عليه السلام: "الإسراف يفني الجزيل". (عيون الحكم
والمواعظ - علي بن محمد الليثي الواسطي - ص 39).

51 “Ujunul Hikemi uel Meua’idh” i Ali ibn
Muhamed El Lejthij El Uasiti, f. 39.

Hadithi 35

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*“Kush ka pasuri, le t’i largohet shkatërrimit,
sepse dhënia e pasurisë në vend të gabuar është
shpërdorim dhe teprim. Kjo e ngre emrin e tij te
njerëzit, por e ul atë tek Allahu”.*⁵²

عن الإمام علي عليه السلام: "من كان له مال فإياه والفساد، فإنَّ
إعطاءك المال في غير وجهه تبذير وإسراف، وهو يرفع ذكر صاحبه في
الناس ويضعه عند الله". (بحار الأنوار - العلامة المجلسي - ج 75 ص 97).

52 “Biharul Enuar” i eruditit El Mexlisi, vëll. 75, f. 97.

Hadithi 36

Ebu Abdullahu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “O Ubejd, me të vërtetë, shpërdorimi sjell varfëri”.⁵³

عن أبي عبد الله عليه السلام أنّه قال: "يا عبيد إنّ السرف يورث الفقر¹. (الكافي - الشيخ الكليني - ج 4 ص 55).

53 “El Kafi” i Shejkh Kulejnit, vëll. 4, f. 55.

Hadithi 37

Ebu Abdullahu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Me shpërdorimin pakësohen bekimet”.⁵⁴

قال أبو عبد الله عليه السلام: "إنَّ مع الإسراف قِلَّةَ البركة".²

(وسائل الشيعة - الحر العاملي - ج 21 ص 556).

⁵⁴ “Uesailu Esh Shi’ah”, Hurrul Amili, vëll. 21, f. 556.

Hadithi 38

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*"Mjerë për shpërdoruesin! Sa larg është nga
përmirësimi i vetes dhe nga rregullimi i
çështjeve të tij!"*⁵⁵

وقال عليه السلام: "ويح المسرف، ما أبعدته عن صلاح نفسه،
واستدراك أمره". (مستدرك الوسائل - الميرزا النوري - ج 15 - ص 266).

⁵⁵ "Mustedrekul Uesail", Mirza en Nuri, vëll. 15, f. 266.

Hadithi 39

Ebu Hasani, Imam Musa Kadhimi (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: *“Butësia është gjysma e jetesës dhe askush nuk do të varfërohet, nëse është i matur në shpenzime”*.⁵⁶

عن أبي الحسن موسى عليه السلام: "الرفق نصف العيش وما عال امرء في اقتصاده". (الكافي - الشيخ الكليني - ج 4 ص 54).

56 “El Kafi” i Shejkh Kulejnit, vëll. 4, f. 54.

Hadithi 40

Ebu Abdullahu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: *"Katër personave nuk u pranohen lutjet; njëri prej tyre është ai që ka pasur pasuri dhe e ka shpërdoruar, pastaj thotë: 'O Zot, më furnizo!' Atëherë Allahu i Plotfuqishëm i thotë: 'A nuk të kam urdhëruar të jesh i matur në shpenzim?'"*⁵⁷

قال أبو عبد الله عليه السلام: "أربعة لا يستجاب لهم، أحدهم كان له مال فأفسده فيقول: يا ربّ ارزقني، فيقول الله عزّ وجلّ: ألم آمرك بالاعتصام". (م. ن. - ج 4 ص 56).

57 Po aty, vëll. 4, f. 56.

إسم الكتاب: اربعون حديثا عن الاقتصاد و التدبير

الاعداد: مركز نون للتأليف والترجمة

المترجم: الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: يربا كولا

التصحيح اللغوى: إسراء مريا

الإخراج النهائي: صريه فزا

الغلاف: صريه فزا

الناشر: مؤسسة القرآن الكريم

تيرانا- البانيا- 2026